

Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

**Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**


A handwritten signature in black ink, appearing to be 'L. Bana', with a small '1' written below it.

Tabela e përmbajtjes

A. BILANCI KONTABEL	3
B. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	4
C. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	5
D. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA	6
E. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	7-13

Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF
BILANCI KONTABEL
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2016
në LEK

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	2,955,906	2,752,021
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	6,787,149	3,982,968
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura		1,643,050	-
Të tjera llogari të arkëtueshme		-	-
Inventari	6	3,809,613	3,432,942
Shpenzime të shtyra		-	-
Total Aktive Afatshkurtra		15,195,718	10,167,931
Aktivët afatgjatë			
Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		-	-
Aktive afatgjatë materiale	7	361,869	468,127
Aktive afatgjatë jomateriale		-	-
Llogari të tjera të arkëtueshme		-	-
Total aktive afatgjatë		361,869	468,127
Total Aktive		15,557,586	10,636,058
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari të pagueshme tregtare	8	1,104,386	1,248,060
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	9	-	196,950
Detyrime tatimore	10	430,018	331,486
Parapagimet e arkëtuara		-	-
Te tjera detyrime		-	-
Total Detyrime afatshkurtra		1,534,404	1,776,496
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë		-	-
Total Detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		1,534,404	1,776,496
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		-	-
Rezerva statutoare		-	-
Rezerva të tjera		-	-
Fitime të mbartura		6,811,979	3,338,800
Fitimi i ushtrimit		7,211,204	5,520,762
Total kapitali		14,023,183	8,859,562
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		15,557,586	10,636,058

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin ushtrëmor të mbyllur më 31 Dhjetor 2016

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e rezultatit 31 Dhjetor 2016

ne LEK

Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	46,487,426	41,889,854
Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(35,882,249)	(33,873,580)
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(34,251,837)	(31,814,669)
2) Te tjera shpenzime	(1,630,412)	(2,058,911)
Shpenzime te personelit	(2,016,260)	(1,396,795)
1) Paga dhe shperblime	(1,565,316)	(1,054,603)
2) Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	(450,944)	(342,192)
Zhvleresim i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(106,258)	(124,638)
Shpenzime te tjera te shfrytëzimit	-	-
Shpenzime financiare	1,110	173
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	-	-
2) Shpenzime te tjera financiare	1,110	173
Fitimi/humbja para tatimit	8,483,769	6,495,015
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	(1,272,565)	(974,252)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	(1,272,565)	(974,252)
2) Shpenzimi aktual i tatimit te shtyre	-	-
Fitimi/humbja e vitit	7,211,204	5,520,762
Te ardhura te tjera gjithperfshirese per vitin:	-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithperfshirese per vitin	-	-
Totali i te ardhurave gjithperfshirese per vitin	7,211,204	5,520,762

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF
PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE (cash flow)
Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Të gjitha balancat janë në lekë)

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		8,483,769.200	6,495,015
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		(1,272,565)	(974,252)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		106,258	124,638
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:			
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(4,447,231)	(2,765,368)
Rënie/(rritje) në inventarë		(376,670.170)	(989,094)
Rënie/(rritje) në shpenzime të shtyra		-	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(242,093)	(2,248,596)
Rritje/(rënie) në parapagimet e arketuara		-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		2,251,468	(357,657)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve			
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera			
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera			
Dividentë të arkëtuara			
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		-	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral			
Pagesa e huave			
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare			
Interes i paguar			
Dividendë të paguar		- 2,047,583	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		- 2,047,583	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		203,885	- 357,657
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		2,752,021	3,109,677
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	2,955,906	2,752,021

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL
Për vitin ushtrimor te mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e Levizjeve te kapitalit


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014					3,338,800	3,338,800
Efekt i ndryshimeve në politikat kontabël						-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015				3,338,800	(3,338,800)	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						-
Fitimi / Humbja e vitit					5,520,762	5,520,762
Transferim ne rezerva						-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015	-	-	-	3,338,800	5,520,762	8,859,562
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016				5,520,762	(5,520,762)	-
Shpërndarje fitimi				(2,047,583)		(2,047,583)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						-
Fitimi / Humbja e vitit					7,211,204	7,211,204
Transferim ne rezerva						-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	-	-	-	6,811,979	7,211,204	14,023,183

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Per Njesine Ekonomike

Magrip Bana

Tirane , me 25/03/2017



Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në lekë).

1. Të përgjithshme

HISTORIA DHE KRIJIMI

Njesia ekonomike "Magrip Bana", është regjistruar si person fizik prane QKR-se Tirane me dt.02/05/2014 me NIPT L41702004L.

Selia e njësise ekonomike është: Rruga: Durrësit, Njesia Bashkiake Nr.9, Pallati nr.240, Shk.6, Ap.44, Kati1, prane sheshit Karl Topia.

AKTIVITET KRYESOR

Veprimtaria kryesore tregtare e njësise ekonomike për ushtrimin 2016 është tregtimi i produkteve dhe pajisjeve kancelari te ndryshme.

Në 31 dhjetor 2016 shoqëria ka 4 punonjës (3+1).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes


Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë e, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Njësia ekonomike.



Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në lekë).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Euro/LEK	135.23	137.28

a. Instrumenta financiarë


Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Njesia ekonomike bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të njësisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur njësia transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën njësia angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.



Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në lekë).

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se njësia nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.


2.1. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt



Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në lekë).

me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e aplikuarat për vitin 2016 janë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.6. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në lekë).

3.7. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Para ne dore	84,190	67,861
Para ne Banka	2,871,716	2,684,159
Totali	2,955,906	2,752,021

4. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare dhe detyrimet nga palet e lidhura.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Kliente	6,787,149	3,982,968
Kerkesa të tjera të arkëtueshme	1,643,050	-
Totali	8,430,199	3,982,968

5. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

Inventari


	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Mallra për rishitje	3,809,613	3,432,942
Totali	3,809,613	3,432,942

6. Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM-te)

Gjendja e *Aktiveve Afatgjatë Materiale* sipas grupimeve në strukture me datë 31.12.2016 paraqitet si më poshtë:

Aktive afatgjatë materiale

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Makineri dhe pajisje	201,716	262,230
Aktive të tjera afatgjatë materiale	160,153	205,897
Totali	361,869	468,127

11


Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në lekë).

kurse shtesat, pakesimet, amortizimet dhe vlera e mbetur ose kostoja e amortizuar paraqitet si me poshte:

	Toka e Ndertesa	Makineri Pajisje	Mjete transporti	Te tjera aktive	Totali
Kosto e AAM-ve 01.01.2016	-	-	378,216	311,361	689,577
Shtesa	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-
Kosto e AAM-ve 31.12.2016	-	-	378,216	311,361	689,577
<i>Amortizimi</i>					
Amortizimi AAM-ve 01.01.2016	-	-	115,986	105,464	221,450
Shtesa	-	-	60,515	45,743	106,258
Pakesime	-	-	-	-	-
Amortizimi AAM-ve 31.12.2016	-	-	176,501	151,208	327,708
<i>Vlera neto 01.01.2016</i>	-	-	262,230	205,897	468,126
<i>Vlera neto 31.12.2016</i>	-	-	201,715.20	160,153.06	361,868

7. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	1,104,386	1,248,060
	1,104,386	1,248,060

8. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Detyrime ndaj ortakut	-	196,950
	-	196,950

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Tatim mbi fitimin	67,731	2,252
TVSH per tu paguar	294,756	262,247
Sigurimet Shoqerore e Shendetsore	52,234	51,690
Akcize	-	-
Tatim mbi e ardhurat personale	6,297	6,297
Tatime e taksa te tjera	9,000	9,000
Totali	430,018	331,486

Pasqyrat Financiare 2016

Magrip Bana PF

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në lekë).

10. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Njësia ekonomike është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% . Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Ne pasqyren e mëposhteme do të paraqitet formula e Fitim/Humbjes të Vitit Financiar në dy periudhat e fundit në krahasim:

Te ardhura	01.01.-31.12.2016	01.01.-31.12.2015
Nga shitjet	46,487,426	41,889,854
Kosto e shitjeve		
Shitje mallra e shërbime	38,004,767	35,395,013
Fitimi nga veprimtaria	8,482,659	6,494,841
Interesa të fituara Neto	221	173
Diferenca kembimi Neto	889	-
Fitimi Bruto	8,483,769	6,495,015
Shpenzime të pazbritshme	-	-
Baza llogaritjes së Tatimit Fitimit	8,483,769	6,495,015
Tatim Fitimi (15%)	1,272,565	974,252
Fitimi Neto për Vitin	7,211,204	5,520,762

ANGAZHIME DHE PASIGURI

Detyrimet tatimore

Librat e Njësive ekonomike nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen perfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

